

Prill, 2023

Të Dashur Familje dhe Nxënës të Klasave të 9 - ta të Ardhshme.

Është nderi im dhe kënaqësia e veçantë të mirëpres fëmijën tuaj si anëtar i klasës së maturantëve të dyqind e tetëdhjetë e gjashtë të “Central High School”. Dita e parë e shkollës për vitin shkollor 2023-2024 është **E Martë, 5 Shtator 2023**. Kjo letër përmban informacione rreth gjërave më të rëndësishme që duhen ditur ndërsa fëmija juaj përgatitet për tranzicionin e ardhshëm të shkollës së mesme.

Të gjithë nxënësit e klasës së nëntë të shkollës sonë marrin gjashtë lëndë të kërkuara: English 1, Algebra 1, Biology, World Language 1, World History dhe një kombinim të dy nga kurset e mëposhtme që bëhen në gjysëm viti : Art, Music, Theater dhe Physical Education. Programi për klasat e 9 -ta është krijuar me mundësi të kufizuara për individin. Të gjithë nxënësit e klasës së nëntë do të kenë mundësinë të marrin pjesë në provimin e “ Algebra 1 Honors” Algebra 2 ose “ Algebra 2 Honors”. Të gjithë nxënësit e klasës së nëntë do të renditen gjithashtu në bazë të preferencës “ World Language”. Ofertat e kursit të “ World Language” janë Spanjisht, Frëngjisht, Italisht, Kineze - Mandarin dhe gjuha Latine Të gjithë nxënësve të “Central High School “ u kërkohet të mësojnë një gjuhë për dy vite radhazi. Studentët duhet të zgjedhin një gjuhë që është e re për ta; ne nuk i lejojmë studentët të marrin një gjuhë që flitet në shtëpi. Në javët në vijim, do të merrni një komunikim vijues në lidhje me provimet e vendosjes.

Leximi veror është një kërkesë për të gjithë nxënësit e klasës së 9-të që vijnë. Informacionet rreth teksteve tona të leximit të verës do të jenë të disponueshme në “ [school website](#) . Ne nuk presim që studentët të fillojnë leximin e tyre veror përpara përfundimit të klasës së 8 - të. Qëndroni të sintonizuar për më shumë informacione.

Të gjitha familjet e nxënësve të klasave të 9 - ta të ardhshme inkurajohen fuqimisht të marrin pjesë në Orientimin e Studenteve të Rinj në Gusht. Kjo është ngjarja zyrtare e mirëseardhjes për studentët që vijnë dhe është projektuar që studentët dhe prindërit/kujdestarët të marrin pjesë së bashku. Seancat do të përfshijnë një asamble mirëseardhjeje dhe vizita me udhëzues në ndërtesë, si dhe mundësinë që studentët të bëjnë fotografinë e tyre të identitetit / (ID photo), do të bëhet caktimi i dollapit , dhe do të shikojnë orarin e tyre studentor. Veshjet në lidhje me uniformën e “Central High School “ dhe artikuj të tjerë shkollor do të jenë në shitje në këtë kohë. Udhëheqësit Orientues (nxënësit e klasave 10-12) do të udhëzojnë dhe do t'i përgjigjen çdo pyetjeje që mund të kenë studentët në lidhje me shkollën e mesme. Orientimi i Ri i Studentëve organizohet sipas mbiemrit të studentit dhe do të mbahet në datat dhe oraret e mëposhtme:

- Studentët me Mbiemra nga: A - F: **E Enjte, 24 Gusht, ora 9:00 - 11:30 am**
- Studentët me Mbiemra nga: G - L: **E Enjte, 24 Gusht, ora 12:30 - 3:00 pm**
- Studentët me Mbiemra nga: K - Q: **E Premte, 25 Gusht, ora 9:00 - 11:30 am**
- Studentët me Mbiemra nga: R - Z: **E Premte, 25 Gusht, ora 12:30 - 3:00 pm**

Nëse ju ose fëmija juaj nuk mund të merrni pjesë në seancën e caktuar Orientuese, ju lutemi zgjidhni një seancë tjetër orientuese për të marrë pjesë. Nëse ju ose fëmija juaj nuk mund të merrni pjesë në asnjë nga sesionet tona orientuese, ju lutemi drejtojeni fëmijën tuaj që të paraqitet në shkollë ditën e parë të shkollës. Të gjitha informacionet që do të jepen në seancat e datës 24 dhe 25 Gusht do të bëhen publike në faqen tonë të internetit të shkollës.

ALBANIAN LANGUAGE

Faleminderit,

*Presidenti Davis*



# CENTRAL HIGH SCHOOL

SCHOOL DISTRICT OF PHILADELPHIA

1700 West Olney Avenue  
Philadelphia, PA 19141  
215-400-3590  
Fax: (215) 400-3591

**Kate Davis**, *President*  
**Theresa Harrington**, *Asst Principal*  
**Tracy Scott**, *Asst Principal*  
**Aviva Snyder**, *Asst Principal*  
**James Brooks**, *Asst Principal*

BE PART OF THE PROGRESS